



VENDIM

K.P.P. 241/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.04.2018, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt “Mirëmbajtja e Objekteve Ndërtimore” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës, me nr. REF-41292-01-22-2018, me fond limit 5,829,264 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.02.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “MENI” sh.p.k
Adresa: Rr. “Shinasi Dishnica”, P. UniCom tek Selvia, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Universitar i Traumës.
Adresa: Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 23.01.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt “Mirëmbajtja e Objekteve Ndërtimore” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës, me nr. REF-41292-01-22-2018, me fond limit 5,829,264 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.02.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumës.

II.2 Në datën 06.02.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 12.02.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | | |
|---|----------------|---------------|
| i. “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. | 4,415,975 lekë | skualifikuar; |
| ii. ”MENI” sh.p.k. | 5,453,586 lekë | kualifikuar; |

II.4. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, në datën 19.02.2018 BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Nga verifikimet e kryera, rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar ankesën e BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. dhe ka kryer rivlerësimin në datë 23.02.2018, duke njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi rezultatet e këtij rivlerësimi, të cilat rezultojnë si më poshtë:

- | | | | |
|-----|--|----------------|--------------|
| i. | “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. | 4,415,975 lekë | kualifikuar; |
| ii. | ”MENI” sh.p.k. | 5,453,586 lekë | kualifikuar; |

II.5.Në datën 27.02.2017 operatori ekonomik ankimues ”MENI” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës të BOE “Junik” sh.p.k. & “Dimension Construction” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Firma “MENI” shpk pasi eshte njohur me kerkesat e pjesemarrjes ne tenderin e organizuar nga Autoriteti Kontraktor (AK) date 06.02.2018 me objekt “Mirembajtja e objekteve ndertimore” ka hedhur ne sistem dokumentacionin e kerkuar sipas Dokumentave Tenderit (DT) shtojca 7. Ne daten 12.02.2018 ne portalin Mesazhe njihemi me klasifikimin e ofertave ku oferta jone eshte fituese dhe oferta e operatorit ekonomik DIMENSION CONSTRUCTION eshte e skualifikuar. Ne daten 23.02.2018 po ne portalin Mesazhe njihemi me nje klasifikim te ri te ofertave pjesemarrrese ku oferta e operatorit ekonomik DIMENSION CONSTRUCTION eshte kualifikuar. Gjithashtu ne Opsionin Kerkesa te faqes se APP, ku hidhen dokumentat e tenderit vihemi ne dijeni se opertatorit DIMENSION CONSTRUCTION i eshte kerkuar nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave (KVO) te beje dhe te pranoje korrigjimin e ofertes, per shkak te gabimeve arithmetike. Nisur nga ky fakt sqarojme se: Ne zbatim te Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Në nenin 51 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, pika 2, thuhet shprehimisht se; Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikoje“ në çfarëdo mënyre ofertën. Operatori ekonomik DIMENSION CONSTRUCTION nuk ka bere gabim arithmetik ne oferten e tij, hedhur ne sistem per kete tender, por ka nderhyre, modifikuar oferten e tenderuar sipas shtojces 11 të DT, konkretisht ka ndryshuar, modifikuar sasine ne zerin 33 dhe 162 te formularit te ofertes.(bashkengjitur kesaj ankese dokumenti i KVO) Në nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, thuhet shprehimisht se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit..... ” Ne DST....

Kapitulli II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIK Seksioni 1. Hartimi i ofertës pika 1.1 thuhet shprehimisht: Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu nje nder parimet baze te pjesemarrjes ne tender eshte ai i transparences, barazise dhe mosdiskriminimit bazuar në nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes” te Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Kjo nenkupton qe operatoret ekonomik duhet te jene ne pozicion te barabarte ne momentin e hapjes, shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave nga KVO, gje qe nuk ka ndodhur me oferten e opertatorit DIMENSION CONSTRUCTION pasi pervec nderhyrjes, modifikimit te ofertes, i mungojne edhe analizat teknike te cmimeve per cdo ze te kosos, vendosur ky kriter nga Njesia e Prokurimit ne Seksionin 2, pika 6. te KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT ne Dokumentat Standarte te Tenderit. Duke u nisur nga faktet e mesiperme theksojme me bindje se KVO ka kualifikuar oferten e operatorit DIMENSION CONSTRUCTION ne kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe Dokumentat Standarte te Tenderit “Mirëmbajtja e Objekteve Ndërtimore”. [...]

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 380/1 Prot. datë 01.03.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "MENT" sh.p.k., duke mos pranuar pretendimet të ngritura prej tij.

II.6. Në datën 06.03.2018 operatori ekonomik ankimues "MENT" sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, si dhe ka shtuar pretendime lidhur me ofertën e paraqitur nga BOE "Junik" sh.p.k. & "Dimension Construction" sh.p.k. si më poshtë vijon:

"[...] Gjithashtu bëjmë me dije K.P.P se operatori ekonomik DIMENSION CONSTRUCTION përveç nderhyrjes, modifikimit të ofertes, i mungojnë në sistem edhe analizat teknike të cmimeve për çdo ze të koston, vendosur ky kriter nga Njesia e Prokurimit në Seksionin 2, pika 6. të KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT në Dokumentat Standarte të Tenderit. [...]"

II.7. Në datën 15.03.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.452/1prot., datë 13.03.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "MENT" sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të BOE "Dimension Construction" sh.p.k. & "Junik" sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentin se *"[...] Operatori ekonomik DIMENSION CONSTRUCTION nuk ka bërë gabim arithmetik në ofertën e tij, hedhur në sistem për këtë tender, por ka nderhyrë, modifikuar ofertën e tenderuar sipas shtojcës 11 të DT, konkretisht ka ndryshuar, modifikuar sasine në zerin 33 dhe 162 të formularit të ofertes. [...]"*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, shtojca 11, "Termet e Referencës", nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

"Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore në SUT - Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj sipas zërave të punës dhe sasive referuese të mëposhtme si dhe specifikimeve teknike (shtojca 8):"

Nr	Emërtimi (Zerat e punës)	Njësia	Sasia referuese
	A - PUNIME NDËRTIMI		
1	Mur me tulle të lehtësuar dopio deri 3m me llac perzier M25	m ³	10
2	Mur me tulle me gjashtë vrima, t=12cm, h~3m, llac perzier M15	m ³	10

3	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe nje shtrese katrama	m ²	50
4	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe dy shtresa katrama	m ²	50
5	Hidroizolim me nje shtrese mapej	m ²	50
6	Hidroizolim me dy shtresa mapej	m ²	50
7	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	Copë	30
8	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC fi= 120mm	ml	80
9	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm	ml	80
10	Trotuar me pllaka granili me boje pa bordure betoni	m ²	100
11	Bordura trotuari 20x35 cm te parapergatitura	ml	50
12	Nënshtresë zhavori	m ³	50
13	Shtresë rëre	m ³	20
14	Shtresë betoni C 7/10	m ³	20
15	Shtresë rëre në territorin e ndërtesave	m ³	20
16	Shtrese me pllaka porcelanat importi	m ²	50
17	Suva brenda mure tulle h~4m me krah, llac perzier M25	m ²	50
18	Suvatim me grafiato h > 4 m	m ²	100
19	Plintuse pllake grez	ml	60
20	Veshje me pllaka majolike	m ²	50
21	Shtrese pllaka mermeri t=3mm	m ²	50
22	Patinim muri allci (stuko)	m ²	100
23	Patinim tavani allci (stuko)	m ²	50
24	Suva e zakonshme fasade mur tulle h~8m	m ²	50
25	Suva e zakonshme fasade mur tulle h mbi 8m	m ²	50
26	Ndertim muri me kanuf t=10 cm me dy shtresa	m ²	50
27	Tavan kartongjes	m ²	150
28	Tavan I varur me pllaka gipsi 60x60 cm	m ²	150
29	Veshje muri me kartongjes cimentato	m ²	50
30	Sherbitisje e bojatisje me gelqere	m ²	150
31	Boje vaji sipërfaqe druri	m ²	50

32	Boje vaji sipërfaqe metalike	m ²	50
33	Boje hidroplastike	m ²	300
34	Prishje mure tulle pa pastrim	m ³	30
35	Prishje shtresa betoni	m ³	30
36	Lluster cimento 2 cm 1:2	m ²	80
37	Prishje Suvatimi në masën 50%	m ²	50
38	Prishje Suvatimi në masën 100%	m ²	50
39	Veshje muri me knauf me nje shtrese	m ²	50
40	Mbulim çatie me panel sanduiç	m ²	50
41	Suvatim Shpatulla	m ²	50
42	Suvatim Tavani h~4m	m ²	100
43	Pastrim ulluqe shkarkimi h>8m	ml	100
44	Pastrim tarrace	m ²	150
45	Riparim catie llamarine	m ²	100

B - PUNIME HIDRAULIKE

46	F.V saraconeske bronxi fi 1/2" = 15 mm	Copë	15
47	F.V saraconeske bronxi fi 1 1/2" = 40 mm	Copë	15
48	F.V ËC allafranga importi	Copë	15
49	F.V bide importi porcelani	Copë	15
50	F.V bolier 100 liter importi	Copë	15
51	F.V hidrante fi=100mm	Copë	10
52	F.V pilete dysHEMEJE fi=50mm	Copë	10
53	F.V Saracineske PPR 1/2"	Copë	15

54	F.V Saracineske PPR 3/4"	Copë	15
55	F.V Rezervuar zingato 5000 litra	Copë	1
56	F.V Rezervuar zingato 2000 litra	Copë	1
57	F.V bolier 80 liter, uje te ngrohte	Copë	5
58	F.V bolier 12 liter, uje te ngrohte sanitar	Copë	5
59	F.V tuba e rakorderi PVC	kg	20
60	Tub kanalizimi pvc fi=110mm	ml	20
61	Tub kanalizimi pvc fi=200mm	ml	20
62	F.v Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d = 25 mm, t = 2.0 mm, PN 10	ml	50
63	F.v lavaman porcelani I vogel	Copë	30
64	F.v lavaman porcelani I madh	Copë	20
65	F.v kasete ëc plastike	Copë	30
66	F.v kasete ëc porcelani	Copë	30
67	F.v tub fleksibel 50 cm	Copë	100
68	F.v tub shkarkimi fizarmonike	Copë	100
69	F.v galexhant kasete ëc	Copë	100
70	F.v galexhant depozite	Copë	50
71	F.v grup dushi	Copë	20
72	F.v grup lavamani	Copë	100
73	F.v grup lavamani tip gjel	Copë	50
74	F.v koke grup dushi e lavamani	Copë	30
75	F.v rubinete 1/2"	Copë	30
76	F.v rubinete 3/4"	Copë	30

77	F.v valvol moskthimi 1/2"	Copë	50
78	F.v pompe uji q=10 l/s, 7,5 Kë	Copë	1

C - PUNIME ELEKTRIKE

79	F.v percjelles PV-500 fi 1.5 mm2	ml	50
80	F.v percjelles PV-500 fi 2.5 mm2	ml	50
81	F.v percjelles PPV, fi 2 x 1.5 mm2	ml	50
82	F.v Celesa e priza 10 A	Copë	60
83	F.v Celesa e priza 10 A me nulifikim	Copë	30
84	F.v portollampa normale 10 A	Copë	30
85	F.v Siguresa ~ 25 A	Copë	30
86	F.v priza bivalente 220V 10 A 2P-T Gevis	Copë	40
87	F.v priza shuko "Gevis" universal	Copë	100
88	F.v priza shuko jashte murit 2P+T IP=54 "Gevis"	Copë	80
89	F.v priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A "Gevis"	Copë	80
90	F.v Celes 1 polar 220 V 10 A "Gevis"	Copë	50
91	F.v Celes 2 polar 220 V 10 A "Gevis"	Copë	50
92	F.v Automat termo/el.manj. Diferencial 2P 220V, 32A dI = 0.03A	Copë	20
93	F.v Automat termo/el.manj. Diferencial 2P 220V, 16A dI = 0.03A	Copë	20
94	F.v Automat termo/el.manj. Diferencial 2P 220V, 16A	Copë	20
95	F.v Automat termo/el.manj. Diferencial 2P 220, 32A	Copë	20
96	F.v Automat termo/el.manj. Diferencial 2P 220V, 40 A	Copë	20
97	F.v Automat termo/el.manj. Diferencial 2P 220, 63A	Copë	10
98	Çeles automat termo-elektro magnetik 2P 20A 220V	Copë	5

99	Automat termo-elektro magnetik 4P 380V 40A	Copë	5
100	Ndricues fluoreshent 2x36ë, IP40	Copë	20
101	Ndricues projektor me llampe SAP-T 250ë	Copë	5
102	Ndricues tip plafoniere, me llapme fluoreshente 40ë	Copë	10
103	Ndricues tavanor fluoreshente 1x40ë	Copë	10
104	Ndricues tavanor fluoreshente 1x18ë	Copë	10
105	Ndricues plafonier brace 1x40ë	Copë	20
106	Ndricues tip spot me llampa fluoreshente, 2x18ë	Copë	40
107	Ndricues plafonier muror 1x60ë	Copë	10
108	Ndricues fluoreshent 4x18ë, IP40	Copë	40
109	Ndricues fluoreshent 2x40ë, IP40	Copë	40
110	Ndricues plafonier led D-20/20ë IP-65	Copë	50
111	Ndricues incaso led 60x60/40ë	Copë	100
112	F.V celsa e priza ndricimi te zakonshme brenda murit	Copë	50
113	F.V celsa e priza ndricimi 2 polare brenda murit	Copë	20
114	F.V portollampa te zakonshme	Copë	30
115	F.V automat elektro magnetik 1 fazore 16 A	Copë	10
116	F.V automat elektro magnetik 1 fazore 25 A	Copë	10
117	F.V automat elektro magnetik 1 fazore 32 A	Copë	10
118	F.V automat elektro magnetik 3 fazore 25 A	Copë	10
119	F.V automat elektro magnetik 3 fazore 32 A	Copë	10
120	F.V automat elektro magnetik 3 fazore 63 A	Copë	10
121	F.V automat elektro magnetik 3 fazore 125 A	Copë	5
122	Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A	Copë	5

123	F.V Llampe te thjeshte	Copë	100
124	F.V Portollampe porcelani me 3 vrima	Copë	10
125	F.V llampe Ndriculesi Luminishent 15 Ë me 13000 ore pune	Copë	100
126	F.V llampe Ndriculesi Luminishent 18 Ë me 13000 ore pune	Copë	150
127	F.V llampe Ndriculesi Luminishent 18 Ë te gjate me 13000 ore pune	Copë	100
128	F.V llampe Ndriculesi Luminishent 18 Ë te gjate dhe te holle me 13000 ore pune	Copë	40
129	F.V llampe Ndriculesi Luminishent 36 Ë me 13000 ore pune	Copë	200
130	F.V llampe Ndriculesi Luminishent 36 Ë te gjate me 13000 ore pune	Copë	100
131	F.V llampe Ndriculesi Luminishent 36 Ë te gjate dhe te holle me 13000 ore pune	Copë	50
132	F.V Starte ndricuesish Luminishent 15 Ë	Copë	50
133	F.V Starte ndricuesish Luminishent 18 Ë	Copë	100
134	F.V Starte ndricuesish Luminishent 36 Ë	Copë	100
135	F.V Drozel ndricuesish Luminishent 15 Ë	Copë	50
136	F.V Drozel ndricuesish Luminishent 18 Ë	Copë	50
137	F.V Drozel ndricuesish Luminishent 36 Ë	Copë	50
138	F.v Llampe prozhektori halogjene 500 ë me 13000 ore pune	Copë	10
139	F.v Llampe prozhektori halogjene 1000 ë me 13000 ore pune	Copë	10
140	F.v Llampe Prozhektori LED 75 ë me 13000 ore pune	Copë	5
141	F.V rezistence Buljeri	Copë	20
142	F.V Reostat Buljeri	Copë	20
143	F.V Salvavite 1 fazore 20 A	Copë	5
144	F.V Salvavite 1 fazore 25 A	Copë	5
145	F.V Salvavite 1 fazore 32 A	Copë	5

146	F.V Salvavite 1 fazore 63 A	Copë	5
147	F.V Salvavite 3 fazore 20 A	Copë	5
148	F.V Salvavite 3 fazore 25 A	Copë	5
149	F.V Salvavite 3 fazore 32 A	Copë	5
150	F.V Salvavite 3 fazore 63 A	Copë	5
151	F.v Spine me Tokezim	Copë	30
152	F.v Suporte Geëis	Copë	80
153	F.v Kapake Geëis	Copë	80
154	F.v Percjelles Elektrik 3 x 2.5 mm2	ml	50
155	F.v ndricues Prozhektor 500 ë me Llampe halogjene	Copë	8
156	F.v ndricues Prozhektor 1000 ë me Llampe halogjene	Copë	8
157	F.v Role Korposkulare 25 A	Copë	10
158	FV - Kabell CAT6 FTP	ml	400
159	FV Priza kompjuterike RJ-45/cat6 me kapak mbrojtës	Copë	10
160	FV Priza telefonie RJ -45/ cat5 me kapak mbrojtës	Copë	10
161	FV Pach panel 24 porta RJ-45/ UTP-CAT6	Copë	3
162	Montim Sëitch I monitorueshem 24 porta RJ -45 + porte FO	Copë	3
163	FV Pach korda 1.5 ml per RJ-45 FTP-CAT6	Copë	50

D - PUNIME KANALIZIME TË UJËRAVE TË ZEZA

164	Pastrim pusete	m ³	55
165	Thithje e pastrim puseta, gropa septike me autobot	Rrugë	10
166	Zhbllokim kanale te ujerave te zeza	ml	50
167	Pastrim, zhbllokim ËC + kollona shkarkimi	Copë	50

168	Pastrim, zhbllokim lavamane + sifona	Copë	50
169	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m ³	30
170	F.v Kapake pusete betoni	m ³	5

E - PUNIME MARANGOZI

171	Riparim dyer dritare druri	Copë	40
172	Riparim dyer dritare duralumini	Copë	40
173	Riparim dyer dritare plastike	Copë	35
174	Dritare d/alumini dyfish xham.	m ²	5
175	Dyer d/alumini dopio xham.	m ²	5
176	F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m ²	5
177	F V dyer d/alumini plastike me dopio xham	m ²	5
178	Dyer druri kashe derrase	m ²	15
179	F.v xham i thjeshte	m ²	25
180	F.v xham akulli	m ²	20
181	F.v xham kunder temperatures	m ²	5
182	F.v dopio xham	m ²	5
183	F.v dopio xham akulli	m ²	5
184	F.v dopio xham akulli me rrjete	m ²	5
185	Riparim rafte, tavolina, karrige	Copë	50
186	F.v brave dere druri	Copë	50
187	F.v brave dere duralumini	Copë	50
188	F.v brave dere plastike	Copë	50
189	F.v fisheke brave per dyer druri	Copë	50

190	F.v fisheke brave per dyer duralumini	Copë	50
191	F.v fisheke brave per dyer plastike	Copë	50
192	F.v doreza brave per dyer druri	Copë	50
193	F.v doreza brave per dyer duralumini	Copë	50
194	F.v doreza brave per dyer plastike	Copë	50
195	F.v doreza te rrumbullaketa	Copë	10
196	F.v mentesha per dyer druri	Çifti	20
197	F.v mentesha per dyer duralumini	Çifti	20
198	F.v mentesha per dyer plastike	Çifti	20
199	F.v mentesha me dy hapje per dyer druri (tip kauboy)	Çifti	20
200	F.v mentesha me dy hapje per dyer duralumini (tip kauboy)	Çifti	30
201	F.v mentesha me dy hapje per dyer plastike (tip kauboy)	Çifti	30
202	F.v shula vertikal per dyer druri	Copë	30
203	F.v shula vertikal per dyer duralumini	Copë	30
204	F.v shula vertikal per dyer plastike	Copë	30
205	F.v shula horizontal per dyer druri	Copë	30
206	F.v shula horizontal per dyer duralumini	Copë	30
207	F.v shula horizontal per dyer plastike	Copë	30
208	Riparim grila dritaresh	m ²	30
209	F.v grila duralumini	m ²	10
210	F.v rrjete kunder insekteve	m ²	20
211	Punime Saldimi	kg	10

”

III.1.2. BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. ka paraqitur shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, i cili përmban zërat e punimeve sipas seksioneve përkatëse të preventivit, të plotësuar me emërtimin, njësité, sasisë, cmimet për njësi dhe në total.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës “Kërkese për rregullimin e gabimeve aritmetike”, autoriteti kontraktor i është drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomik “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k., me anë të së cilës i kërkon korrigjimin e ofertës si më poshtë vijon:

“Konkretisht është:

Nr	Emërtimi	Njësia	Cmimi	Sasia	Vlera
33	Bojë hidroplastike	m2	50	200	10,000
162	Montim Sëitch i monitorueshëm 24 porta Rj-45+portë FO	Copë	5,000	5	25,000

Duhet

Nr	Emërtimi	Njësia	Cmimi	Sasia	Vlera
33	Bojë hidroplastike	m2	50	300	15,000
162	Montim Sëitch i monitorueshëm 24 porta Rj-45+portë FO	Copë	5,000	3	15,000

III.1.4. Në nenin 51, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “1. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji. 2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të përcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën.”

Public Health Sector

III.1.5. Në nenin 53, pika 1 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” Ndërsa në pikën 3, të dispozitës së mësipërme thuhet shprehimisht: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”;

III.1.6. Në nenin 66, pika 4 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: - Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. - Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Nëse pas kërkesës së

komisionit të vlerësimit të ofertave, ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë. [...]”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi formularin e ofertës me zërat e preventivit të plotësuar nga BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. konstatoi se në zërat e preventivit: 33 – “Bojë hidroplastike” dhe 162 - “Montim Sëitch i monitorueshëm 24 porta Rj-45+portë FO”, ky i fundit ka ndërhyrë duke ndryshuar sasi të kërkuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 11 të dokumentave standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, duke ulur 100 njësi në zërin 33 dhe shtuar 2 njësi në zërin 162 të preventivit. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon se, zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë se, operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. ka ndryshuar strukturën e preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi ka shtuar ose ulur sasi të zërave konkretë të tij. Komisioni gjykon se, nuk jemi në kushtet e mospërputhjes të cmimit për njësi me cmimin total, apo mospërputhjes ndërmjet fjalëve dhe shifrave, të parashikuara në nenin 66, pika 4 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të preventivit. Neni 51 i ligjit të prokurimit publik, nuk e lejon autoritetin kontraktor të modifikojë ofertën, duke ndryshuar sasi të zërave të punimeve në preventiv. Gjithashtu sic parashikohet në nenin 53, pika 1 të këtij ligji, nga ana e autoritetit kontraktor nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “MENI” sh.p.k. qëndron.

III.2.. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MENI” sh.p.k., mbi kualifikimin e ofertës të BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentin: *“Gjithashtu bëjmë me dije K.P.P se operatori ekonomik DIMENSION CONSTRUCTION perveç nderhyrjes, modifikimit te ofertes, i mungojne ne sistem edhe analizat teknike te cmimeve per cdo ze te kosos, vendosur ky kriter nga Njesia e Prokurimit ne Seksionin 2, pika 6. te KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT ne Dokumentat Standarte te Tenderit.”*, konstatohet se operatori ekonomik ankimues “MENI” sh.p.k. në ankimin e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, nuk e ka ankimuar pretendimin e sipërcituar, por ka ngritur vetëm pretendimet e cituara në pikën III.1 të këtij vendimi, e rrjedhimisht ankimi mbi këtë pretendim i paraqitur prej tij nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ, pasi për faj të vetë ankimuesit, ankimi i këtij pretendimi në KPP nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Për rrjedhojë, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MENI” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me objekt “*Mirëmbajtja e Objekteve Ndërtimore*” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës, me nr. REF-41292-01-22-2018, me fond limit 5,829,264 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 06.02.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Universitar i Traumës.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MENI” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 424 protokoli Datë 06.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha